

Pse duhet te vaksinohemi?

Vaksina mbron femijen, familen dhe mjedisin tuaj kundër sëmundjeve infektuese, disa prej të cilave mund të jenë shumë të rrezikshme. Brenda një afati kohor vaksina mund të zhdukë sëmundje.

Çfarë është vaksina?

Përbërësit e vaksinave janë agjentë infektivë të vrarë ose pjesërisht aktivë. Kur vaksinohemi sistemi i imunitetit reagon dhe krijon antitropa. Sistemi i imunitetit reagon shumë shpejt kur ndesh mikrobet e vërteta dhe antitrupat janë në gjendje të neutralizojnë mikrobet. Ndodh që me kalimin e viteve antitrupat dobësohen dhe duhet të bëhet vaksinim tjetër.

U rekomandojmë me forcë që të vaksinoni fëmijët plotësisht

U këshillojmë që, në interes të fëmijës dhe mjedisit, të ndiqni skemën e plotë siç është paraparë nga Këshilli i Lartë i Mjekësisë në Belgjikë. Skema bazë përmban vaksinat kundër sëmundjeve të mëposhtme: Poliomeleti, Difteria, Tetanozi, Pertussis (kolla e mirë), Haemophilus Influenzae B, Hepatiti Viral B, Fruthi, Parotiti, Rubeola, Meningitit C, Pneumokoku dhe Rotavirus. Filloni në kohë dhe respektoni moshën e skemës së vaksinimit. Në këtë mënyrë merrni masat e duhura që fëmija juaj të jetë i mbrojtur në mënyrë optimale. Nga ana ligjore vetëm vaksina kundër poliomeletit është e detyrueshme.

Efektet dytësore serioze janë shumë të rrallë

Efektet anësore të lehta janë të mundshme: temperaturë mesatare (më pak se 38,5 °C), dhimbje e lehtë, skuqje, enjtje apo forcim i vendit ku është injektuar vaksina, ndonjëherë një kokërr apo raste diarrije (pas vaksinës rotavirus). Për këtë nuk ka nevojë për mjekim dhe simptomat kalojnë vetvetiu.

Pas vaksinës kundër fruthit, parotitit apo rubeolës fëmijë mund të ketë temperaturë të lehtë 5 deri 12 ditë pas vaksinimit. Nodh që fëmija të ketë skuqje lëkure dhe/ose dhimbje gjymtyrësh.

Nëse fëmija qan shumë, ka shumë dhimbje dhe në rast se jeni shumë në merak kontaktoni mjekun. Në kapitullin temperaturatura (fq 63 dhe 64) lexoni si mund reagoni në rast temperature.

Nuk ekzistojnë prova shkencore mes vaksinimit dhe sëmundjeve serioze apo kronike.

Ne tabelën e mëposhtme gjeni informata të mëtejshme mbi pasojat e sëmundjeve infektuese dhe efekteve të mundshme anësore të vaksinave.

Vaksinat të cilat nuk janë pjesë e skemës

Përveç vaksinave përfshirë në skemën bazë ekzistojnë edhe vakcina të tjera, si psh kundër meningjitit B, hepatitis A, lisë dhe vaksinave për udhëtim. Këto vakcina nuk këshillohen.

Nëse doni të dini nëse fëmija juaj ka të nevojshme vakcina të tilla këshillohuni me mjekun e familjes apo pediatrin.

Fruthi dhe udhëtim

Brenda Bashkimit Evropian numri i fruthit është në ngjitje. Fëmijët në moshë 6 dhe 12 muajsh që udhëtojnë në një zonë me rrezik (p.sh Rumani, Greqi, Itali dhe Francë) mund të vaksinohen më shpejt seç parashihet, nga mosha 6 mujore. Vakcina që jepet më shpejt duhet të trajtohet si dozë ekstra. Dy vaksinat e tjera që parashihen në skemën e vaksinimit janë ta nevojshme për të qenë i mbrojtur.

Dhe ju prindër kontrolloni vaksinat e nevojshme para se të udhëtoni.